

VENDIM
Nr.955, datë 24.11.2010

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I
SHËTITORES SË ORIKUMIT “FAZA III”, NË BASHKINË E ORIKUMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5/1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i shëtitores së Orikut “Faza III”, në bashkinë e Orikut.
2. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë së Orikut.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen prej 50 (pesëdhjetë) m², tokë truall, pronë private, në masën 893 350 (tetëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e treqind e pesëdhjetë) lekë.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Orikut, planifikuar në buxhetin e saj.
5. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
6. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Orikut.
7. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Orikut, për realizimin e këtij projekti.
8. Regjistrimi i ri i pasurisë, 50 (pesëdhjetë) m², tokë truall, shpronësuar në favor të bashkisë së Orikut, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Orikut për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË
SHPRONËSOHEN PËR “NDËRTIMIN E SHËTITORES ORIKUM, FAZA E TRETË”
NË BASHKINË E ORIKUMIT**

Nr.	Emër, mbiemër	Sipërfaqe truall m²	Çmimi lekë/m²	Vlera në lekë	Numri i pasurisë	Zona kadastrale
1	Zyber Kumanaku	50	17 867	893 350	408/183	2832
	Totali	50		893 350		